



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

**Fakulteti:** Bujqësisë dhe Veterinarisë

**Departamenti:** \_i Teknologjisë Ushqimore \_\_\_\_\_

**Programi:** \_\_MSc Shkenca e Ushqimit \_\_\_\_\_

**NJOFTIM**

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti ) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Ardita Bakija \_\_\_\_\_, me titull: “ \_\_\_\_\_Aflatoksinat në misër dhe miell misri \_\_\_\_\_”

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data \_\_13.12.2024\_\_\_\_\_ deri me datë \_\_20.12.2024\_\_\_\_\_.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Asoc. \_\_Salih Salihu\_\_\_\_\_ , kryetar,
2. Prof. Asoc. Arbenita Hasani \_\_\_\_\_, mentor - anëtar,
3. Prof. \_Ass. Esad Behrami \_\_\_\_\_, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës \_prof. Asoc. Dr. \_Arbenita\_Hasani\_, përmes e-mail adresës [arbenita.hasani@uni-pr.edu](mailto:arbenita.hasani@uni-pr.edu) \_\_\_\_\_.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

## ABSTRAKT

Cilësia dhe siguria e misrit ndikohet nga shumë faktorë, ndër të cilët toksifikimi me aflatoksina është një prej më të rëndësishmëve. Ky hulumtim ka analizuar praninë e aflatoksinave në misër dhe miell misri duke përdorur metodën ELISA KITT. Në total, janë testuar 40 mostra të misrit nga rajonet të ndryshme të Kosovës.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të përcaktojë nivelin e aflatoksinave dhe të krahasojë këto

nivele me standardet e lejuara ndërkombëtare.

Mykotoksinat janë metabolite dytësore që prodhohen nga disa lloje fungale dhe myk. Në kushte të favorshme, si temperatura e lartë dhe lagështia, ato ndotin një numër të madh mallrash ushqimore dhe kulturash rajonale gjatë fazave para dhe pas vjeljes. Aflatoksinat janë mykotoksinat kryesore që dëmtojnë shëndetin e kafshëve dhe të njeriut për shkak të natyrës së tyre kancerogjene. Aflatoksinat lëshohen kryesisht nga *Aspergillus flavus* dhe *Aspergillus parasiticus*. AFB1 është lloji më i dëmshëm i aflatoksinave dhe është një hepato-kancerogjen, mutagjen dhe gjithashtu dëmton sistemin imunitar.

Për të ruajtur sigurinë ushqimore dhe për të parandaluar ndotjen nga aflatoksinat në kulturat ushqimore, është e nevojshme të ndiqen metoda të kombinuara, që përfshijnë përdorimin e varieteteve rezistente ndaj aflatoksinave dhe praktikata e rekomanduara bujqësore. Ndërhyrjet për

kontrollin e aflatoksinave shpesh përqendrohen në fazën pas vjeljes, por masat e duhura gjatë zhvillimit të kulturave mund të ndihmojnë në reduktimin e ndotjes në nivele të konsiderueshme.

Aktualisht, përdorimi i bio-pesticideve është një ndërhyrje e zakonshme në shumë vende për të

kontrolluar ndotjen nga aflatoksinat. Ky shqyrtim i përditësuar ofron një pasqyrë të burimeve të kontaminimit, përhapjes, ndikimit dhe teknikave të zbulimit, duke u përqendruar në strategjitë e menaxhimit dhe përdorimin e bio-pesticideve për të kontrolluar aflatoksinat.

Ky hulumtim ofron një pasqyrë të rëndësishme për të kuptuar dhe menaxhuar ndotjen me aflatoksina në misër dhe miell misri. Përdorimi i metodës ELISA KITT për detektimin e aflatoksinave ndihmon në ruajtjen e standardeve të sigurisë ushqimore. Për të zvogëluar ndikimin e aflatoksinave, është e nevojshme të ndërmerren masa të kujdesshme gjatë të gjitha fazave të prodhimit dhe përpunimit të kulturave.

Fjalët Kyçe: aflatoksina, ELISA KITT, masat e kontrollit, misër, miell misri